



ANALIZË E EFEKTEVE EKONOMIKE TË PAKOS SË RINGJALLJES – NGA PREMTIMET POLITIKE NË MASA SHTETËRORE



Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Qeverisja Demokratike

Publikuar: Korrik, 2022

Të gjeturat, opinionet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Hyrje	5
Metodologjia	7
Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike	8
Masa 1 - Mbështetja e Punësimit	11
Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit	16
Masa 3 - Mbështetja për familjen	20
Masa 4 - Mbështetja për publikën	23
Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient	25
Përfundime	26
Rekomandime	27

Lista e shkurtesave

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

BKS – Byroja Kosovare e Sigurimit

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

INDEP – Instituti për Politika Zhvillimore

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit

ME – Ministria e Ekonomisë

MFPT – Ministria e Financës, Punës dhe Transfereve

MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MSH – Ministria e Shëndetësisë

PRE – Pakoja e Ringjalljes Ekonomike

STEM – Fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës

TI – Teknologjia e informacionit

Hyrje

Efektet negative të pandemisë COVID-19, derisa gjatë kohës së mbylljes në tremujorin e dytë të vitit 2020 patën ndikimin më të madh në ekonominë e Kosovës, ndikimi afatgjatë vazhdon të vërehet në aspekte të ndryshme ekonomike edhe sot. Si përgjigje për ndikimin ekonomik të pandemisë COVID-19, Qeveria e Kosovës ndër morri një sërë masash, të cilat fillimisht ishin të natyrës ad-hoc, ndërsa pas konsolidimit të veprimeve u transformuan në pako të rimëkëmbjes, e pasaj pako të ringjalljes ekonomike, me qëllim të rikthimit të ekonomisë së Kosovës në binarë të zhvillimit dhe tejkalimit të stagnimit, posaçërisht në sektorët më të prekur nga pandemia COVID-19. Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (PRE) e miratuar në korrik të vitit 2021, u fokusua në adresimin e ndikimit negativ të COVID-19 në punësim dhe prodhim, si dhe u projektua si pako për investime në sektorin publik dhe infrastrukturë. Me vlerë prej 420 milionë euro, pakoja u nda në 5 masa kryesore, të ndara në nënmasa specifike të cilat, një vit pas aprovimit të pakos, janë ende në zbatim. Përveç mbështetjes së punësimit, ringjalljes së ekonomisë dhe prodhimit, si dhe mbështetjes për familjet dhe sektorin publik, Qeveria e Kosovës gjithashtu ka shfrytëzuar këtë pako për të shtyer përpara rimbëkëmbjen e gjelbër, duke paraparë investime në infrastrukturë dhe ambient.

Kosova, edhe pse në fillimin e krizës së pandemisë COVID-19 hyri me qëndrueshmëri ekonomike dhe rritje rreth 4% në vit, pësoi rënie të dukshme ekonomike gjatë vitit 2020 me rreth -5.3%, duke shënuar normë reale të rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV) prej mbi 10% në vitin 2021.¹ Kjo rimëkëmbje ekonomike, kryesisht e bazuar në rritje të konsumit ka krijuar momentum pozitiv në ekonominë e Kosovës. Sipas Bankës Botërore, rritja e transfereve dhe konsumit qeveritar prej 38% dhe rritja e remitencave prej 15%, kanë ndikuar dukshëm në zbutjen e tkurrjes ekonomike si rezultat i COVID-19.² Në anën tjetër, tregu i punës, i cili edhe para pandemisë COVID-19 ishte në gjendje jo të kënaqshme, u përkeqësua gjatë krizës. Sipas OECD, punëtorët që punojnë në punë të paqëndrueshme dhe rreth 35% e të punësuarve që punojnë në sektorin joformal janë më të ndikuarit nga kriza ekonomike e pandemisë.³

Pezullimi i rregullit të deficitit buxhetor për vitin 2020, rezultoi në një rritje të deficitit buxhetor në pothuajse 7,6 % të PBB-së, edhe pse investimet publike ranë me më shumë se 28 %, megjithatë shpenzimet publike u rritën me 18,6 %. Rënia e të ardhurave nga taksat uli të ardhurat publike me 9 %. Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë në përgjigje të pandemisë arritën rreth 4.4% të PBB-së, me 0.9% shtesë të shpenzuara në menaxhimin e pandemisë dhe 3.5% në mbrojtje sociale, punësim dhe mbështetje të fortë (Banka Botërore, 2020).

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”, projekt i cili mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID-i, ka analizuar dhe monitoruar procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, në faza periodike. Procesi i analizës dhe monitorimit bëhet në mënyra të ndryshme, përmes raporteve

¹ Banka Qendrore e Kosovës, Treguesit Makroekonomik, qasur në korrik 2022: <https://bqk-kos.org/eag/sq/>

² Banka Botërore, Rimëkëmbja e Gjelbër, qasur në: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/36402/Greening-the-Recovery.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

³ OECD, Analiza shumëdimensionale e Kosovës,

monitoruese dhe infografikave. Ky raport i rradhës, është raporti i tretë dhe njëkohësisht i fundit i monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Raporti i tretë i monitorimit është fokusuar në të dhënat e marra nga Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Administrata Tatimore e Kosovës, Byroja Kosovare e Sigurimit, Agjencia e Punësimit të Kosovës, Fondi për Garanci Kreditore e insitucione të tjera përgjegjëse.

Raporti i tretë i monitorimit është i realizuar në kuadër të procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, dhe është përpiluar duke monitoruar gjithë periudhën e zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes. Në përgjithësi, procesi i monitorimit përfshin edhe publikimin e buletineve të cilët deri tani kanë arritur shifrën 7, gjithsej 12 infografikave informuese, 3 podcastëve dhe 2 diskutimeve live me akterë të rëndësishëm me të cilët analizohet Pakoja e Ringjalljes dhe gjendja aktuale në raport me pandeminë COVID-19. Të gjitha këto aktivitete kanë për qëllim informimin e qytetarëve rreth masave mbështetëse të Pakos si dhe zbatimit të saj. Këto aktivitete të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) tentojnë që të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, e në të njëjtën kohë të mbajnë të informuar qytetarët rreth masave dhe përfitimeve që kanë ata ndaj Pakos së Ringjalljes Ekonomike.



Metodologjia

Hartimi i këtij raporti mbështetet në metodologji të përzier, duke u bazuar në analizë sasiore të ndikimit ekonomik të pakos së ringjalljes ekonomike, por edhe duke përdorur metoda cilësore për vlerësimin e ndikimit përtej analizës sasiore.

Metoda sasiore e hulumtimit është përdorur për analizën e treguesve kryesor ekonomik dhe të dhënave të publikuara nga institucionet e Kosovës, si mënyrë për të matur ndikimin numerik të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Raportet dhe dokumentet e publikuara nga institucionet e Kosovës dhe nga institucionet tjera përkatëse janë konsultuar dhe përdorur në analizën cilësore të ndikimit ekonomik të pakos.

Treguesit kryesor ekonomik janë analizuar bazuar në të dhënat e publikuara nga institucionet relevante. Sidoqoftë duke pasur parasysh një nivel të diskrepancës në mes të të dhënave nga institucionet kryesore, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), si institucioni kyç i mbledhjes dhe publikimit të të dhënave, janë përdorur si bazë. Përveç ASK, të dhënat dhe analizat e realizuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Tregtisë (MINT) janë marrur për bazë në këtë hulumtim.

Është me rëndësi të ceket që mungesa e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave të caktuara, posaçërisht të të dhënave të tregut të punës dhe punësimit, si dhe të dhënave të anketës së buxhetit të familjes, e bën të pamundshme të analizohet dhe vlerësohet specifikisht ndikimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike në dy masa, atë të mbështetjes së punësimit dhe mbështetjes për familjen. Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar të dhënat e punësimit vetëm deri në TM1 të vitit 2021, duke e pamundësuar kështu krahasimin e të dhënave të punësimit.

Përmbledhje e përgjithshme sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike

Masa e parë e Pakos së Ringjalljes kishte për synim mbështetjen e punësimit. Për nënmasën e parë 1.1, rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, janë subvencionuar paga deri në 50% të pagës mujore bruto për 3 muaj. Kjo masë është zbatuar në mënyrë të plotë dhe pas aplikimeve të pranuar janë ekzekutuar pagesat për të gjithë aplikuesit që kanë plotësuar kriteret. Qeveria në vitin 2022 ka ndarë 1 milion Euro për vazhdimin e zbatimit të kësaj mase, por edhe masave 1.2 dhe 1.3.

Nënmasa e dytë e kësaj Pako, 1.2 mbështetja për të punësuarit e formalizuar, gjatë implementimit ka motivuar punëdhënësit të deklarojnë punëtorët duke ju ofruar në shkëmbim rimbursim. Nënmasa 1.2 dhe 1.3, mbështetja e punësimit të grave, u implementuan në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës. Zbatimi i subvencioneve për këto nënmasa ka qenë i planifikuar deri në qershor të këtij viti për të ofruar kohë të mjaftueshme për mbështetjen e punëtorëve jo formal dhe grave në punë.

Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë është nënmasa 1.4 e Pakos, dhe në kuadër të kësaj skeme është implementuar një projekt, i cili ka paraparë punësimin e 170 të diplomuarve, por përfundimisht kanë qenë vetëm 63 përfitues. Përfituesit e kësaj skeme janë punësuar në Qendra për Punë Sociale (QPS), Zyra e Pensioneve, Qendrat për të Moshuar, Qendrat për Aftësi të Kufizuar dhe OJQ-të e licencuara në komunën përkatëse. Projekti i dytë i cili është në fazat fillestare të implementimit “Aftësitë për Tregun e Punës – Fit for Job”, zbatohet në bashkë-financim me GIZ, dhe synon punësimin e 300 të rinjve.

Në kuadër të nënmasës 1.5, trajnimi dhe punësimi në TI, janë mbështetur maturantët e interesuar në fushën e TI dhe studentet vajza/gra në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM). Maturantët përfitues kanë qenë 943, që janë përzgjedhur për të ndjekur kurse në trajnimi në fushën e TI-së. Ndërsa mbështetje financiare u është ofruar 552 vajzave në fushat e STEM. Nënmasa 1.6, mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta është planifikuar të bëhet në bashkëpunim me OJQ përmes trajnimit në punë. Nënmasa ka filluar zbatimin dhe është hapur aplikimi për OJQ, por ende nuk ka filluar faza trajnuese.

Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit është masa e dytë e Pakos së Ringjalljes dhe synon të adresoj problemet që ka shkaktuar pandemia COVID-19 në ekonominë e vendit. Nënmasa 2.1, subvencionimi i kredive investive, ka synuar të nxis investime tek bizneset prodhuese. Zbatimi i masës nuk ka qenë i plotë pasi që aplikimi për kredi financiare ka mbetur i hapur deri në qershor të vitit 2022. Nënmasa 2.4, mbështetja e eksportit është prezentuar së bashku me masën 2.1, sepse ka synuar mbështetjen e bizneseve prodhuese me subvencionim për ngritje të kapaciteteve për gjetjen e tregjeve të reja. Kjo nënmasë nuk është zbatuar akoma sepse është akoma në fazën e parë të operacionalizimit.

Nënmasa 2.2 parasheh mbështetjen e bizneseve për qasje në financa. Për këtë nënmasë janë ndarë fonde por akoma nuk ka filluar zbatimi i saj. Nënmasa 2.3, Investime në TI dhe Inovacion, dhe 2.6, rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura, kanë mbetur pa zbatim. Në anën tjetër, për nënmasën 2.5 ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agroturizmit, janë ndarë mjetet financiare dhe ka filluar zbatimin.

Masa e tretë e Pakos së Ringjalljes ka targetuar sferat sociale në të cilat ka pasur efekt negativ pandemia COVID-19. Masa mbështetja për familjen është ndarë në tetë nënmasa për kategori të ndryshme sociale. Nënmasa 3.1, mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, është zbatuar në plotëni, sepse është ofruar mbështetje financiare për familjet që kanë humbur kryefamiljarin e tyre. Nënmasat 3.2, mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale, dhe 3.5, pagesa për lehonat e papuna, tashmë janë kthyer në politika të përhershme.

Për nënmasën 3.3, reformimi i Skemës së Asistencës Sociale deri tani vetëm është nënshkruar marrëveshje e financimit për 'Projektin e Reformës së Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë' në mes të MFPT dhe Bankës Botërore. 'Kuponë ushqimi për familjet në nevojë' është nënmasa 3.4 e cila shtë zbatuar në bashkëpunim me OJQ që ofrojnë shërbime sociale. Nënmasa 3.6 ka synuar mbështetjen e likuiditetit familjar ku Qeveria ka subvencionuar qytetarët e Kosovës 10% të kredive konsumuese, deri në shumën 10.000 euro. Përfitues të kësaj nënmase ishin 3,396 aplikues, por pritët që kjo nënmasë të vazhdojë zbatimin duke subvencionuar aplikues të tjerë.

Mbështetja në tejkalimin e krizës energjetike, e planifikuar nga nënmasa 3.7 do të zbatohet nga ME e cila do të transferojë 20 milion Euro nga mjetet buxhetore të KEK për subvencionimin e importit të energjisë elektrike. Ndërsa rritja e rezervave shtetërore në kuadër të nënmasës 3.8 do të zbatohet në koordinim me MINT dhe MFPT.

Sfidat nga sferat e ndryshme të jetës në Kosovë si arsimit, shëndetësia, kultura e siguria i ka prekur masa e katërt e Pakos, mbështetja për publikun. Nënmasa 4.1, mbështetja për shëndetësinë ka filluar zbatimin në vitin 2021 me mbështetje financiare prej 10% të pagës bruto për stafin shëndetësor në sektorin publik, por nuk ka të dhëna për vazhdimin e zbatimit të kësaj nënmase në vitin 2022. Për mbështetjen për arsim të paraparë nga nënmasa 4.2, përveçse janë ndarë fonde, nuk ka të dhëna zyrtare për zbatimin e saj.

Për mbështetjen e kulturës dhe sportit nga nënmasa 4.3 janë ndarë fonde të cilat janë planifikuar të investohen në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sport, dhe mbështetje të rinisë. MKRS ka qenë mjaft aktive në këto fusha dhe nënmasa mund të vlerësohet se është zbatuar plotësisht. Në kuadër të nënmasës 4.4 që synon mbështetjen e sigurisë, MFPT ka hapur llogarinë zyrtare bankare për pranimin e fondeve nga qytetarët e RKS-së dhe diaspora për të kontribuar në Fondin e Sigurisë.

Mbështetja e mërgatës është targetuar nga nënmasa 4.5, ku Qeveria e Kosovës fillimisht ka zvogëluar kostot e policës kufitare për mërgimtarët që vijnë në Kosovë, kurse prej janarit të vitit 2022 qytetarët e Kosovës me targa të huaja pasi të paguajnë policën e plotë në sportelet e Byrosë Kosovare të Sigurimit, mund të aplikojnë për rimbursim në platformën online e-Kosova. Ndërsa për mbështetjen e ndërmarrjeve publike, Qeveria e Kosovës përmes nënmasës 4.6 ka ndarë fonde në mënyrë që ndërmarrjet publike të kenë mundësinë e huamarrjes me kthim pa interes, për të përballuar obligimet e tyre financiare.

Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes është masë e një rëndësie të veçantë, pasi targeton sfidën globale të ndryshimeve klimatike. Për këtë masë janë ndarë fonde nga Qeveria e Kosovës, mirëpo nga ana praktike nuk ka filluar zbatimi i saj.



Vlerësimi i masave nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike- Nëpërmjet treguesve përkatës

Masa 1 - Mbështetja e Punësimit

Masa 1 e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, ajo e cila ka për qëllim mbështetjen e punësimit, në vlerë prej 50 milionë euro, ka synuar mbështetjen e punëkërkesve dhe punësimit, në mënyrë që të minimizojë ndikimin negativ të pandemisë COVID-19, por edhe të shërbejë si mënyrë për krijimin e vendeve të reja të punës, e mbi të gjitha formalizimin e punësimit. Tregu i punës në Kosovë, edhe para pandemisë COVID-19 ka qenë i pabarabartë, duke i shpërfaqur pabarazitë në mes të grave dhe burrave, grupeve etnike, por edhe duke lënë rininë në margjinat e tregut të punës. Si rezultat, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike ka synuar që nëpërmes kësaj mase të ndikojë edhe në uljen e këtyre pabarazive. Përveç kësaj, duke qenë që personat e punësuar në punë të paqëndrueshme dhe në sektorin joformal janë ndikuar nga humbja e vendeve të punës në masë dukshëm më të madhe, mbështetja për ri-punësimin e atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, ka synuar të zbusë rritjen e pabarazisë.

Nëmasat e parapara në Masën për mbështetjen e punësimit në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë si në vijim.

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë – në vlerë prej 10 milionë euro.
 - Kjo nënmasë është realizuar duke subvencionuar, për periudhë tremujore, pagën në vlerë prej € 170 në muaj, të të gjithë atyre që kanë humbur punën në periudhën mars 2020 – prill 2021.
2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar – në vlerë prej 10 milionë euro
 - Kjo nënmasë parasheh mbështetjen e punonjësve të rinj, që nuk kanë qenë të punësuar formalisht në tre muajt paraprak duke u paguar kontributet pensionale në vlerë prej 10% të pagës deri në 12 muaj.
3. Mbështetja e punësimit të grave – në vlerë prej 5 milionë euro
 - Kjo nënmasë ka për qëllim adresimin e pabarazisë gjinore në tregun e punës, duke subvencionuar 50% të pagës (deri në maksimum prej 150 euro në muaj) për periudhë tremujore, për të gjitha gratë që nuk kanë qenë të punësuar në tre muajt e fundit. Pas përfundimit të periudhës tremujore, gratë e punësuar që kanë përfituar nga kjo masë, do të kalojnë në mbështetje sipas nënmasës 1.2, duke u paguar kontributet pensionale.
4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë – në vlerë prej 10 milionë euro
 - Kjo nënmasë ka për qëllim adresimin e disavantazhit në punësim me të cilin ballafaqohen të rinjtë. Sipas kësaj mase, skema e punësimit të garantuar për të rinjtë të moshës 18-24 vjeç parasheh subvencionimin e pagës minimale për të gjithë të rinjtë të kësaj moshe që punësohen në punën e parë.

5. Trajnimi dhe punësimi në TI – në vlerë prej 5 milionë euro

- Kjo nënmasë parasheh adresimin e hendekut të shkathtësive në tregun e punës me anë të ofrimit të kuponëve për trajnime në fushën e teknologjisë informative dhe duke ofruar mbështetje për punësim në tre muajt e parë për të gjithë ata që përfundojnë trajnimet me sukses.

6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta – në vlerë prej 5 milionë euro

- Me qëllim të adresimit të pabarazive në tregun e punës dhe ofrimit të mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, kjo nënmasë parasheh subvencionimin e 50% të pagës (deri në maksimum € 150 në muaj), për 6 muajt e parë të punësimit të personave me nevoja të veçanta.

7. Skema e granteve për zanatet


- Kjo nënmasë ka për qëllim vetëpunësimin e atyre që janë të gatshëm të mësojnë aftësi të reja, për të cilat do të çertifikohen. Vlera e këtyre granteve ofrohet në shumën deri në 3,000 euro, me destinim blerjen e pajisjeve dhe themelimin e biznesit.

Duke i qëndruar besnik premtimeve politike për mbështetje të punësimit, Qeveria e Kosovës ka dizajnuar masën e parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike për të zbutur ndikimin negativ të pandemisë COVID-19 në punësim dhe për të adresuar mangësitë e tregut të punës. Duke përpiluar masa që synojnë grupe të caktuara, si gratë, rinia, dhe personat me nevoja të veçanta, kjo masë ka karakter gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, me anë të targetimit të grupeve të marginalizuara në tregun e punës, masa 1 e pakos po ashtu tenton të fillojë adresimin e problemeve kyçe të pabarazisë në tregun e punës.



Në mungesë të të dhënave të tregut të punës nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, analiza e ndikimit specifik të mbështetjes për punësim në kuadër të Pakos së Ringjalles Ekonomike mbetet e mangët. Sidoqoftë, bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës mund të vërejmë ndryshimin e numrit të të punësuarve para dhe pas fillimit të zbatimit të pakos. Duke filluar në gusht 2021, numri i të regjistruarve si të punësuar në ATK ka filluar të shënojë rritje graduale, duke arritur rritjen më të madhe në tremujorin e fundit të vitit 2021, si periudhë kur zbatimi i nënmasës 1.1 të Pakos së Ringjalles Ekonomike ishte në nivelin më të lartë. Kështu, duke qenë që në mungesë të të dhënave nga ASK nuk mund të vlerësohet nëse kjo masë ka arritur rritjen e punësimit, mund të vërejmë që ka arritur rritjen e formalizimit të punësimit, sipas të dhënave të ATK.

Figure 1: Punëtorët e regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës, 2021




Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Për më tepër, të dhënat nga Trusti tregojnë që numri i kontribuesve aktivë pensionalë është rritur për 13.6% gjatë TM2 të vitit 2021, duke shënuar rritje prej rreth 40,000 vende pune formale krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 dhe 2019.⁴ Për të krahasuar punësimin nëpër vite, sipas të dhënave të ATK, vërejmë që punësimi formal ka shënuar ngritje të madhe në mars dhe prill të vitit 2020, që korrespondon me masat paraprake të rimëkëmbjes ekonomike, mirëpo duke rënë dukshëm në muajt në vijim. Në anën tjetër, rritja e numrit të të punësuarve në ATK për vitin 2021 ka shënuar rritje graduale, deri në tetor 2021, duke filluar rënie të lehtë në muajt në vijim, edhe pse duke qëndruar ende mbi nivelet e viteve paraprake.

⁴ Banka Botërore, Rimëkëmbja e Gjellbër, qasur në: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/36402/Greening-the-Recovery.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Figure 1: Punëtorët e regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës, 2021



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, për tremujorin e parë të vitit 2022, tregojnë që numri i të punësuarve për TM1 2022 ishte rreth 372,379 ishin të punësuar.⁵ Në krahasim me TM1 të vitit 2021, kjo shënon një rritje prej 4.2%.⁶ Sipas Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, rritja më e madhe e punësimit është shënuar në sektorin e patundshmërisë, shëndetësisë, dhe artit, ndërsa rënie kanë pësuar sektori i punësimit të personave fizikë dhe ai i administratës publike.

Në qershor 2022, me përfundimin e zbatimit të nëmasave 1.2 dhe 1.3, ndërsa numri total i përfituesve nga këto masa ende nuk është bërë publik dhe është në proces të verifikimit. Duke qenë që masa 1.3 ka pasur për qëllim përmirësimin e rolit të grave në tregun e punës, është e rëndësishme publikimi i këtyre të dhënave në mënyrë që të vlerësohet nëse kjo masë ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes dhe punësimit të grave në tregun e punës. Në aspektin e punësimit të grave, masa a një-hershme për pagesën prej €100 për të punësuarit që kanë pagë nën €1,000, me fokus të veçantë në sektorin privat, është cilësuar si diskriminuese ndaj grave, duke pasur parasysh nivelin e ulët të punësimit të grave dhe nënperformancën e tyre në tregun e punës.⁷

⁵ Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve, Buletini Makroekonomik, TM1, 2022, qasur në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/mec-dia/8B1DBC03-763D-46F5-8146-72B643730100.pdf>

⁶ Ibid.

⁷ QIKA reagon ndaj Pakos së Ringjalljes Ekonomike, <https://prointegra.ch/qika-reagon-ndaj-pakos-se-ringjalljes-ekonomike/>

Nënmasa 1.4 që ka për qëllim garantimin e punësimit të të rinjve ka filluar me implementimin e përmirësimit të edukimit profesional, me qëllim të zvogëlimit të hendekut të shkathtësive në tregun e punës. Në kuadër të kësaj mase ka filluar zbatimi i projektit me Universitetin e Prishtinës, për ofrimin e punës praktike për zhvillimin e mëtejme të aftësive të studentëve. Sipas raportimeve, ky projekt ka synuar 170 përfitues, por në mungesë të aplikimeve, kanë përfituar nga punësimi i garantuar vetëm 63 të rinjë nga Universiteti i Prishtinës. Mirëpo, duke tërhequr paralele me këtë masë, Qeveria e Kosovës, mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe partnerë tjerë ndërkombëtar, ka filluar zbatimin e Skemës së Garancisë së Rinisë. Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve ka krijuar komisionin ministror për monitorimin e zbatimit të kësaj skeme, ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit do të shërbejë si institucion bazë për zbatimin e kësaj skeme.⁸

Nënmasa 1.5 ‘Trajnimi dhe punësimi në TI’, me qëllim të zvogëlimit të hendekut të shkathtësive në tregun e punës është zbatuar nga MASHTI. Nga kjo masë, me kuponë për trajnime në fushën e TI, sipas ministrisë përkatëse, kanë përfituar 943 maturan⁹ ndërsa 552 gra dhe vajza në STEM janë mbështetur po ashtu nga MASHTI¹⁰. Sidoqoftë, ndikimi afatgjatë i këtyre përfituesve duhet të monitorohet në të ardhmen, duke qenë që në këtë fazë të dhënat ekzistojnë vetëm për përfituesit nga kjo nënmasë, e jo për ndikimin e këtij përfitimi për ta.

Zbatimi e nënmasës 1.6 për mbështetjen e punësimit të personave me nevoja të veçanta ka filluar në qershor 2022 dhe vlerësimi i kësaj mase është i pamundur. Ndërsa të dhënat zyrtare për nënmasën 1.7 mbështetja e vetëpunësimit nëpërmes zanateve, mungojnë dhe si rezultat e bëjnë të pamundur monitorimin e kësaj mase. Sidoqoftë zbatimi i këtyre masave, në çfarëdo shkalle ka potencial të prodhojë efekt pozitiv ekonomik, posaçërisht në zvogëlimin e hendekut të shkathhtësive dhe gjithëpërfshirjen në tregun e punës.

⁸ Zbatimi i skemave të mbështetjes së të rinjve në Ballkan, qasur në: <https://www.vijecemladih.ba/wp-content/uploads/2022/06/Youth-Guarantee-Deployment-in-the-WB6.pdf>

⁹ Vendim për shpalljen e përfituesve të maturanëve për ndjekjen e kurseve në fushën e teknologjisë informatike qasur për herë të fundi tmë 27.06, i qaashëm në <https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3579-per-perfitusve-te-subvencioneve-te-maturanve-per-ndekjen-e-kurseve-ne-fushen-e-ti.pdf> (qasur në qershor, 2022)

¹⁰ Vendim për publikimin e listës të rishqyrtuar të përfituesve të mbështetjes financiare për studentet vajza/gra në fushat e STEM, i qasshëm në <https://spinp.agency/masht/wp-content/uploads/2022/05/vendimi-me-nr-01b-3578-te-perfitusve-te-mbeshtetjes-financiare-per-studen-15-tet-vajza-gra-ne-fushat-e-stem.pdf> (qasur në qershor, 2022)

Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Ndikimi negativ i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës është vërejtur me rënie ekonomike prej mbi 5% në vitin 2020. Sidoqoftë, rimëkëmbja e ekonomisë në vitin 2021 në nivele dyshifrore (rreth 10%) sipas Bankës Qëndrore të Kosovës¹¹, është pritur të ketë efekte pozitive si në ekonomi, ashtu edhe në përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe rritjen e besimit të investimeve.

Për të mbështetur tutje ringjalljen ekonomike, me fokus në prodhim, Masa 2 e Programit të Ringjalljes Ekonomike ka paraparë shumë prej 108 milionë euro për mbështetje të sektorit privat, me fokus të veçantë në investim në teknologji dhe inovacion, e prodhim dhe eksport. Sidoqoftë, duke qenë që edhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i aprovuar dhe i zbatuar deri në fund të vitit 2021, ka qenë në fuqi, zbatimi i kësaj mase është më i ngadaltë. Duke qenë që masat e mëposhtme janë ende në zbatim dhe vlerësimi i ndikimit të tyre është i vështirë.

Masa 2 për ringjalljen e ekonomisë dhe prodhimit parasheh këto nënmasa:

1. Kredi për investime subvencionuese – në vlerë 30 milionë euro
 - Bizneset përpunuese dhe prodhuese do të mbështeten nëse marrin kredi për zgjerimin e kapaciteteve të tyre, duke subvencionuar deri në 20% të principalit të kredisë, përkatësisht 10% të principalit në fillim për të mundësuar një periudha fillestare e mospagimit, si dhe 10% të tjera në fund të kredisë në rast se janë përmbushur objektivat e investimit.
 - Bizneset në pronësi të grave do të mbështeten gjithashtu nëse marrin kredi për të rritur kapacitetet e tyre, deri në 20%, pavarësisht sektorit që operojnë.
 - Bizneset që kanë pësuar rënie të të ardhurave, por kanë ruajtur numrin e të punësuarve dhe tani kanë nevojë për likuiditet për t'u përgatitur për investime të reja, do të mund të subvencionojnë 10% të principalit të kredisë
2. Mbështetja e bizneseve për qasje në financa – në vlerë 43 milionë euro
 - Mbështetje Fondit Kosovar të Garancisë Kreditore duke shtuar kapital edhe për 40 milionë euro të tjera, që do të mundësojë garantimin e rreth 120 milionë eurove kredi shtesë për bizneset.
 - Gjithashtu 3 milionë euro të tjera do të subvencionojnë tarifatat e Fondit, të cilat do të çlirojnë potencialin për 86 milionë euro të tjera kredi të garantuara.
3. Investime në IT dhe inovacion – në vlerë 10 milionë euro
 - 7 milionë euro dedikohen për investime në dixhitalizim dhe inovacion, duke mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme drejt kalimit në epokën dixhitale.
 - 3 milionë euro do të investohen në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren (ITP Prizren) për të krijuar një qendër të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të TI-së. këto investime do të mobilizojnë edhe 4 milionë euro të tjera grante nga donatorët.

¹¹ Banka Qendrore e Kosovës, Treguesit Makroekonomik, qasur në korrik 2022: <https://bqk-kos.org/cag/sq/>

4. Mbështetje për eksport – në vlerë 10 milionë euro
 - Kjo masë do të mbështesë bizneset prodhuese dhe eksportuese në rritjen e cilësisë dhe marzhen e certifikatave të nevojshme. Asistenca në dizajnimin e produktit dhe marketingun do të jetë gjithashtu pjesë e mbështetjes. Do të mbështetet edhe pjesëmarrja në panaire jashtë vendit.
5. Rimëkëmbja e fshatit përmes bujqësisë dhe agroturizmit – në vlerë 10 milionë euro Mbështetja për produktet bujqësore duhet të bëhet edhe përtej prodhimit.
 - Njëpërmjet kësaj mase do të investohet në krijimin e infrastrukturës dhe parakushteve për zhvillimin e agroturizmit në fshatrat tona. Kjo përfshin mbështetjen për investime që do të mundësojnë shndërrimin e shtëpive të fshatit në bujtina që mund të presin mysafirë.
6. Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura – në vlerë 5 milionë euro
 - Kjo masë do të mbështesë bizneset që kanë vuajtur më shumë gjatë pandemisë, dhe për shkak të mbylljes nuk kanë përmbushur detyrimet ndaj institucioneve shtetërore dhe bankave.

Derisa nënmasa 2.1 është ende në zbatim dhe nuk ka të dhëna zyrtare për nivelin e zbatimit, duke qenë që aplikimi për kredi të cilat kualifikohen për mbështetje ka qenë i hapur deri në qershor 2022. Si rezultat, të dhënat për zbatimin e kësaj nënmasë, përveç numrit të ndërmarrjeve të mbështetura, duhet po ashtu të parashohin gjurmimin e ndikimit të këtyre investimeve në mënyrë që të vlerësohet ndikimi real.

Njëllëj, edhe nënmasa 2.2 mbetet pa u zbatuar në tërësi, duke qenë që në kohën kur është aprovuar kjo masë, Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili po ashtu ka paraparë mbështetje të ndërmarrjeve për qasje në financa, ka qenë në zbatim. Buxheti për mbështetje të tarifave të Fondit për Garanci Kreditore, prej €3 milionë është ndarë, mirëpo pjesa tjetër e nënmasës 2.2 nuk është zbatuar ende.

Nënmasa 2.3, e cila parasheh mbështetje për investime në TI dhe Inovacion është në zbatim e sipër. Mbështetja prej €3 milionë për parkun e inovacionit dhe trajnimeve (ITP) në Prizren është realizuar. ITP është funksionalizuar dhe momentalisht ka shtatë biznese inovative që operojnë në kuadër të këtij parku.¹²


Për nënmasën 2.4 ‘Mbështetja e Eksportit’ janë ndarë rreth €7 milionë, të cilat sipas Ministrisë së Financave, Punës, dhe Transfereve, janë shpërndarë sipas listës së përfituesve që janë përzgjedhur në kuadër të projektit “Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport”, përkatësisht te “Programit të Granteve të Përputhshme”.¹³ Përveç kësaj, sektorët eksportues kanë shënuar rritje të dukshme në Kosovë, në krahasim me vitet paraprake. Vlera e eksporteve të Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 ka shënuar

¹² <https://itp-prizren.com/tenants/>

¹³ Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të masës 2.4, qasur në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/me-dia/64326E76-4375-4241-8FA3-D6C1EB226CE6.pdf>

rritje prej rreth 30%, nga €322 milionë në 2021, në €423 milionë në 2022.¹⁴ Edhe krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, eksportet për periudhën janar-qershor 2022 kanë vlerë mbi €30 milionë më të lartë se për periudhën korrik-dhjetor 2022.¹⁵ Është me rëndësi të ceket që rritja e eksporteve ka ndodhur në sektorët me vlerë të shtuar, krahasuar me periudhat paraprake, kur eksporteve e Kosovës janë dominuar nga sektorët me pak ose hiç vlerë të shtuar.

Figure 3: Vlera e eksporteve të Kosovës, në periudha gjashtëmujore, 2021-2022



Burimi: Dogana e Kosovës, 2022

Për nënmasën 2.5 Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit janë alokuar €2.5 milionë¹⁶, mirëpo kjo masë ende nuk është operacionalizuar.

Nënmasa Rikuperimi i hotelierisë dhe bizneseve të mbyllura, nuk ka të dhëna për numrin e përfituesve dhe bizneseve që operojnë në këtë sektor, për periudhën gjashtëmujore të vitit 2022. Sipas ASK, gjatë TM1 të vitit 2022, janë shuar 46 ndërmarrje që kanë qenë duke operuar në sektorin e hotelierisë dhe shërbimeve me ushqim, ndërsa janë regjistruar 279 ndërmarrje të reja në këtë sektor.¹⁷ Si rezultat, leverdia dhe funksionaliteti i sektorit mbetet pozitiv, duke qenë që më shumë ndërmarrje janë regjistruar se shuar në këtë periudhë.

¹⁴ Dogana e Kosovës, Të dhënat e tregtisë së jashtme, qasur në: <https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/statistikat-dhe-arritjet/>

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Vendim 20/50 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 23.12.2021, i qasur në <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

¹⁷ Ndërmarrjet e reja dhe të ri-regjistruara, qasur në: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Statistical%20business%20register_Statistical%20repertoire/enterprises01.px/



Masa 3 - Mbështetja për familjen

Ndikimi social dhe njerëzor i pandemisë COVID-19 është paraparë të zbutet me anë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, sidoqoftë nënmasat e propozuara dhe realizuara në kuadër të masës mbështetja për familjen janë të mangëta. Për të luftuar pabarazitë e thelluara nga pandemia, Qeveria ka paraparë një numër të masave të cilat kanë për qëllim rritjen e mbështetjes sociale për familjet më në nevojë.

Masa 3 – mbështetja për familjen, në vlerë prej 50 milionë euro, parasheh nënmasat e mëposhtme:


1. Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin – në vlerë 4 milionë euro
 - Mbështetje për të gjitha familjet që kanë humbur kryefamiljarin nga COVID-19
2. Mbështetje për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale – në vlerë 17 milionë euro
 - Shtesat për pensionistët do të paguhen, kështu që asnjë pensionist nuk do të ketë pension nën 100 euro, si dhe do të mbështesim familjet që marrin ndihmë sociale me 30% mbi nivelin e rregullt.
3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale – në vlerë 12 milionë euro
 - Reformimi i skemës së ndihmës sociale, në bashkëpunim me Bankën Botërore me synim zgjerimin e saj për të përfshirë më shumë familje në nevojë. Vlera totale e projektit pritet të jetë rreth 47 milionë euro.
4. Kuponë ushqimore për familjet në nevojë – në vlerë 4 milionë euro
 - Për 6 muaj radhazi, në bashkëpunim me UNDP-në dhe financimin e BE-së, 7500 familjeve më në nevojë do t'u shërbehet një kupon ushqimor me vlerë 60-70 euro, në varësi të madhësisë së familjes.
 - Mbështetja do të zgjerohet edhe për 3000 familje të tjera nga komunitetet joshumicë, me mbështetjen e IOM-it.
5. Pagesat për gratë e papuna pas lindjes – në vlerë 3 milionë euro
 - Në kuadër të kësaj skeme, të gjitha gratë pas lindjes që nuk punojnë, do të përfitojnë mbështetje në nivelin e pagës minimale për 6 muaj rresht.
6. Mbështetje për likuiditetin familjar – në vlerë 10 milionë euro
 - Për të përballuar likuiditetin familjar, do të subvencionojmë kredi konsumi deri në 3000 euro.

Nënmasa 3.1 e cila parasheh mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin nga pandemia COVID-19 është zbatuar në tërësi dhe ka mbuluar të gjitha familjet të cilat janë paraqitur për të përfituar nga kjo masë. Numri i total i familjeve që kanë përfituar nga nënmasa 3.1 është raportuar të jetë 3,396. Sidoqoftë, edhe pse kjo masë ka ofruar ndihmë familjeve në nevojë, ajo mbetet jo-gjithëpërfshirëse, duke qenë që lë mënjanë familjet të cilat kanë humbur anëtarë tjerë të familjes të cilët kanë kontribuar në buxhetin familjar, por jo me doemos kanë qenë kryefamiljar.

Nënmasa 3.2 dhe ajo 3.5 janë transformuar nga masa të përkohshme, në masa më afatgjata. Mbështetja e pensionistëve dhe familjeve në asistencë sociale, ashtu që të mos të lejohet të jepet asistencë sociale ose pensioni nën vlerën €100 janë zbatuar si masa dhe janë vazhduar si politika shtetërore për afat të pacaktuar. Gjatë muajit maj 2022, gjatë muajit sipas ASK, 25,482 familje, me mbi 100,000 anëtarë kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ndërsa nga skema e pensioneve bazë të moshës kanë përfituar 149,794 individë. Kjo paraqet një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të Kosovës.

Pavarësisht kësaj, duke pasur parasysh që rritja e çmimeve me të cilën po ballafaqohet ekonomia e Kosovës është enorme, kjo skemë mbështetëse duhet të rishikohet në mënyrë që të akomodojë inflacionin e vitit të fundit. Në përgjithësi, për familjet kosovare, të hyrat mujore kanë shënuar rënie pas pandemisë COVID-19, ndërsa shpenzimet kanë shënuar rritje, siç shihet në figurën më poshtë.

Figure 4: Të hyrat dhe shpenzimet para dhe pas pandemisë COVID-19 për familjet kosovare



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, 2022

Këto të dhëna dhe rritja e vazhdueshme e çmimeve të artikujve bazë (ushqim dhe pije joalkoolike), që në Kosovë përbëjnë rreth 40% të shpenzimeve të secilës ekonomi familjare¹⁸, janë alarm për rishikimin e masave afatgjate të cilat janë krijuar nga këto masa të PRE.

Njëloj, mbështetja e lehonave të papuna, është konsideruar si masë e mirëseardhur dhe e suksesshme, dhe si e tillë është konsideruar të vazhdohet. Përveç kësaj mase, në kuadër të mbështetjes së grave me fëmijë, Qeveria ka filluar edhe realizimin e programit për shtesa të fëmijëve. Nga kjo masë kanë përfituar mbi 13,000 gra deri në përmbyllje të masës si emergjente për ringjallje ekonomike. Sidoqoftë, dizajnimi i masave për mbështetjen e grave duhet të bëhet me kujdes, në mënyrë që të mos shërbejë si incentivë për rritjen e barrës së kujdesit për gratë dhe të

¹⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, qasur në: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/rezultatet-e-anketes-mbi-te-ardhurat-dhe-kushtet-e-jeteses-eu-silc-2018>

mos shërbejë për të cementuar rolin tradicional të grave brenda familjes. Monitorimi i masës së mbështetjes së grave lehona të papuna duhet të bëhet në mënyrë rigoroze, ashtu që të sigurohet që kjo masë nuk shërben si zvogëlim i mundësive për qasjen e grave në tregun e punës, kur ato kanë interesim të bëjnë një gjë të tillë.

Zbatimi i duhur i nënmasës 3.3 ka potencial të ketë ndikim të madh në përmirësimin e mirëqenies sociale në vend. Rishikimi i skemave sociale duhet të sigurojë që ato të targetojnë familjet dhe individët më në nevojë, dhe që ato të shërbejnë jo si bllokim i familjeve në situata të varfërisë por si mundësi për përmirësimin e mirëqenies. Zbatimi i duhur i kësaj mase është i domosdoshëm dhe si i tillë mund të ketë ndikim ekonomik afatgjatë.

Zbatimi i nënmasës 3.4 e cila parasheh Kuponë ushqimi për familjet në nevojë është bërë sipas dizajnit fillestar dhe është realizuar në bashkëpunim me OJQ-të që ofrojnë shërbime të mirëqenies sociale.¹⁹ Kjo masë ka paraparë mbështetje për konsumin ushqimor të familjeve në nevojë me anë të kuponëve deri në €50. Përveç kësaj, kuponët kanë qenë të vlefshëm për përdorim të produkteve të prodhuara në Kosovë, dhe në mënyrë indirekte kanë mbështetur edhe prodhuesit vendor.

Mbështetja e likuiditetit familjar përmes nënmasës 3.6 ka subvencionuar 10% të kredive konsumuese deri në shumën €10,000 për familjet Kosovare. Kjo masë edhe pse në princip është e duhur për të rritur likuiditetin e familjeve në kohë të pasigurisë, duhet të monitorohet me kujdes për të mos lejuar keqpërdorimin e kërkesave për kredi dhe për të mos ndikuar tutje në rritje të inflacionit. Deri në shkurt 2022 kanë përfituar mbi 3,000 familje nga kjo masë, dhe në prill 2022, qeveria ka miratuar €7,3 milion tjera për këtë masë.²⁰

Si masë e cila synon rritjen e likuiditetit dhe huamarrjes së kontrolluar, në vlerë deri në €10,000, kjo masë mund të ketë efekt pozitiv tek familjet. Sipas BQK, mesatarja e shumës së aprovuar të kredive të ekonomive familjare në Kosovë është €5,400²¹, që është brenda limitit të paraparë me këtë masë, dhe me kohëzgjatje mesatare prej mbi 5 vite, që jep sinjal të ndikimit afatgjatë të kësaj mase të ndërmarrë.

¹⁹ Thirrje publike për organizatat jo-qeveritare dhe entitetet tjera që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cenushme të shoqërisë përmes pakove ushqimor në [2B4DCDBE-3B9F-49CE-895E-1B1227597DBA.pdf](https://rks.gov.net/2B4DCDBE-3B9F-49CE-895E-1B1227597DBA.pdf) (rks.gov.net)

²⁰ Vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për masën 3.6 i Qeverisë Nr. 10/69 në [Vendim-i-mbledhjes-se-72-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1.pdf](https://rks.gov.net/Vendim-i-mbledhjes-se-72-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-1.pdf) (rks.gov.net) (Qasur në qershor, 2022)

²¹ Banka Qendrore e Kosovës, Ngarkesa me Borxh e Ekonomive Familjare në Kosovë, qasur në: https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/04/01BQK_NBEF-1.pdf

Masa 4 - Mbështetja për publiken

Mbështetja për sektorin publik, posaçërisht për atë të shëndetësisë dhe arsimit janë të domosdoshme në fazat e ringjalljes ekonomike. Këto sektorë janë ndikuar në masë të madhe gjatë pandemisë COVID-19 dhe kanë qenë qenësore në rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale nga kjo pandemi. Përveç mbështetjes së sektorit publik, kjo masë parasheh që nëpërmes mbështetjes të përmirësohen edhe shërbimet publike të ofruara në Kosovë.

Masa 4 – Mbështetja për publiken me vlerë 112 milionë euro, parasheh këto nënmasa:

1. Mbështetje për shëndetin – me vlerë 53 milionë euro
 - Kjo masë parasheh blerjen e vaksinave dhe shpenzime të tjera që lidhen me menaxhimin e pandemisë. Po ashtu alokimin e mjeteve për blerjen e barnave esenciale si dhe për të mbuluar koston e specialistëve mjekësor.
2. Mbështetje për arsimin – me vlerë 9 milionë euro
 - Kjo masë do të mbulojë boshllëkun e krijuar në të ardhurat vetanake të universiteteve publike gjatë pandemisë, do të mundësojë blerjen e teksteve shkollore për studentët dhe do të sigurojë 1 milion euro bursa për studentët që studiojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.
3. Mbështetje për kulturën dhe sportin – me vlerë 5 milionë euro
 - Me këtë masë parashihet mbështetja e projekteve kulturore dhe sportive.
4. Mbështetje për sigurinë – me vlerë 10 milionë euro
 - Për avancimin e FSK-së drejt një ushtrie moderne që mundëson përmbushjen e misionit të saj, do të përkrahet pagesa për blerjen e pajisjeve dhe mjeteve ushtarake.
5. Mbështetje për diasporën – në vlerë 5 milionë euro
 - Parasheh mbulimin e koston së policave kufitare për të gjithë mërgimtarët që vijnë në Kosovë.
6. Mbështetje për ndërmarrjet publike – në vlerë 30 milionë euro
 - Me këtë masë parashihet kreditimi i ndërmarrjeve publike për të mundësuar zbatimin e planit të rimëkëmbjes.

Nënmasa 4.1, në aspektin e vaksinimit të popullësisë kundër pandemisë COVID-19 ka pasur sukses, duke shënuar Kosovën si shtetin me nivelin më të lartë të vaksinimit në rajon. Kjo ka mundësuar rikthimin më të lehtë në *normalen e re* të ekonomisë, duke u siguruar kështu që të mos ketë mbyllje. Sidoqoftë, niveli i vaksinimit ka stanguar me rënien e rasteve në pjesën e parë të vitit 2022. Në kuadër të kësaj mase, po ashtu, janë mbështetur me shtesa punëtorët e sektorit të shëndetësisë, për 3 muaj të vitit 2021. Sidoqoftë, nga sektori i shëndetësisë kjo masë është konsideruar si e pamjaftueshme dhe me nevojë që rritja e pagave në këtë sektor të bëhet e përhershme.

Nënmasa 4.2, e targetuar drejt sektorëve STEM në arsim është e duhur dhe sipas raportimeve ka filluar zbatimin nga MASHTI, mirëpo nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për zbatimin e kësaj mase. Ndikimi afatgjatë, posaçërisht në tregun e punës, mund të analizohet në vitet në vijim.

Nënmasa për mbështetjen e kulturës dhe sportit ka hasur në probleme gjatë zbatimit nga Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit. Ndarja e mjeteve për realizimin e kësaj mase është bërë nga Qeveria e Kosovës, mirëpo parregullësitë e raportuara gjatë aplikimit dhe përzgjedhjes së OJQ-ve përfituese brenda kësaj mase ka shkaktuar që MKRS të rikthejë procedurat²².

Edhe pse e rëndësisë së madhe, nënmasa 4.4 konsiderohet që është tejet e ulët për realizimin e nevojave në sektorin e sigurisë në Kosovë. Duke qenë kështu, Qeveria ka themeluar Fondin e Sigurisë, për të cilin është hapur llogari bankare për të kërkuar mbështetje nga qytetarët e Kosovës. Mënyra e përdorimit të mjeteve të alokuara dhe atyre të mbledhura në fond, mbetet të vlerësohet në të ardhmen.

Duke pasur parasysh rëndësinë e mërgatës në mbarëvajtjen ekonomike të vendit, nënmasa e cila mbështetë mërgatën duke u lehtësuar barrën financiare të policës kufitare është konsideruar e mirëseardhur dhe është vazhduar për zbatim edhe në vitin 2022. Në 2022, mërgata mund të aplikojë për këtë shërbim me anë të platformës online.²³ Sidoqoftë, përmirësimi i kushteve të udhëtimit, e posaçërisht pritjet e gjata në kufi janë brenga madhore të diasporës, të cilët i konsiderojnë ato si barriera në vizitat e tyre. Reduktimi i barrës financiare pa reduktuar barrën e pritjes, shihet si politikë e mangët.

Mjetet për zbatimin e nënmasës për mbështetjen e ndërmarrjeve publike janë ndarë nga Qeveria e Kosovës²⁴ mirëpo zbatimi i tyre nuk është realizuar në plotni. Është tejet e rëndësishme mbështetja e ndërmarrjeve në sektorin e energjisë si rezultat i problemeve globale me energjinë si rezultat i luftës në Ukrainë. Qeveria e Kosovës tashmë ka kthyer €20 të arkëtuara si dividendë nga KOSTT, tek kjo kompani, duke qenë që KOSTT ka shfaqur probleme likuiditeti. Në anën tjetër edhe Trepça Sh.A. dhe Telekom Sh.A. kanë përfituar nga kjo masë. Duke qenë që këto ndërmarrje janë ende operacionale, nënmasa për mbështetje të tyre ka realizuar ndikimin minimal.



²² https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2714#.Ys_H0HZBzEZ

²³ <https://masa4-5.rks-gov.net/>

²⁴ Vendim nr. 01/53 i Qeverisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 31.12.2021, qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient

Kjo masë parasheh që rreth 100 milionë euro t'i dedikohen investimeve në projekte strategjike që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, si dhe investime në mbrojtjen e mjedisit. Si sektorë me rëndësi jetike për Kosovën, investimi dhe realizimi i kësaj mase është i domosdoshëm.

Investimet në përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore janë të domosdoshme për të mbështetur zhvillimin e industrisë dhe mbi të gjitha të prodhimit dhe eksportit.

Në aspektin mjedisor, Kosova ka nevojë urgjente për investime në mbrojtje të ambientit dhe përmirësimin e industrisë për të mos dëmtuar ambientin dhe për të evituar probleme mjedisore në të ardhmen.



Përfundime

Pakot dhe masat e implementuara të ringjalljes nuk kishin ndërmarrë në konsultim të gjerë publik dhe ishin kryesisht të fokusuara në pagesa direkte për qytetarët. Masat e propozuara nuk ishin konsultuar me qytetarët dhe kishte një listë të qartë të pritjeve për secilën masë. Kjo vështirësoi procesin e monitorimit të masave sepse nuk kishte pikë referente për të ndeshur progresin me rezultatet e mbërritura.

Qeveria nuk kishte qasje të hapur ndaj shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë shoqëror. Në njërin anë, trupa politike e Qeverisë publikonte infografika dhe të dhëna sa i takon ekzekutimit të masave, e në anën tjetër nuk pranonin takime me shoqërinë civile dhe marrja e informatave ishte tejet e vështirë.

Nuk kishte një planifikim të mirëfillt të masave dhe nuk pati një set të kriterëve ekonomike, mjedisore dhe sociale para dizajnit të pakove. Pakoja e ringjalljes nuk pati kriterë ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Implementimi i një pjese të konsiderueshme të masave ishte i mangët apo i pjesshëm. Masa 5 e ringjalljes nuk u zbatua fare dhe një pjesë e masave u zbatuan pjesërisht. Ato që u zbatuan, nuk pati një vlerësim apo evaluim të impaktit të tyre në ekonomi, mjedis dhe në mbrojtjen sociale. Pakoja e rimëkëmbjes nuk pati efekt në rimëkëmbjen e ekonomisë dhe nuk preku shkaqet kryesore të krizës. Pakoja nuk pati efekt transformues të ekonomisë dhe as të stilit të jetës në mënyrë efektive të ishte afatgjatë.

Rekomandime

Për të vlerësuar dhe monitoruar ndikimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, duhet të mblidhen dhe të publikohen të dhëna në kohë të duhur. Qeveria e Kosovës, nëpërmes Agjencisë së Statistikave të Kosovës duhet të sigurohet që të dhënat janë të besueshme dhe të publikuara në kohë. Gjithëpërfshirja mbetet ende problem në Kosovë. Edhe pse PRE ka paraparë disa masa që përmirësojnë gjithëpërfshirjen, pabarazitë e niveleve të ndryshme mbesin të dukshme dhe duhet të adresohen me anë të politikave afatgjate.

Për të mundësuar vlerësimin e ndikimit të masës 1, duhet të publikohen të dhënat e tregut të punës, si dhe të realizohen studime gjurmuese për përfituesit nga skemat e zhvillimit të shkathtësive dhe rritjes së punësimit.

Përfituesit nga masa 2 duhet të monitorohen dhe të sigurohet që zbatimi i kësaj mase të jetë në linjë me parashikimet e ndikimit të përmirësimit ekonomik të sektorit privat. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të mbështetjes së eksportit, duke u siguruar që Kosova të mbajë momentumin e krijuar në rritjen e vlerës së eksporteve.

Mbështetja për arsimin dhe punësimin duhet të realizohet edhe me anë të politikave afatgjate për zvogëlimin e hendekut të shkathtësive dhe t'i adresojë brengat e mungesës së fuqisë punëtore. Masa 3, në nënmasat që janë ende në realizim duhet të sigurohet që të jetë gjithëpërfshirëse dhe të zvogëlojë pabarazitë. Masat e shëndruara në politika afatgjate duhet të sigurohen që adresojnë pabarazitë e nuk i thellojnë ato.

Investimet në infrastrukturë dhe ambient duhet të jenë të synuara drejt një ekonomie të gjelbër që nuk e dëmton mjedisin dhe siguron integrimin e Kosovës në zingjirët global të vlerës e infrastrukturës. Duke qenë në kohë të duhur për të intervenuar, duhet të sigurohet që investimet të jenë në linjë me praktikatat më të mira të një ekonomie të gjelbër dhe miqësore ndaj mjedisit.



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë pikëpamjet dhe opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”